



Procesverbali në dëgjimin publik në : Samadrexhë

Datë : 20.05.2026, 18:00

Pjesëmarrës nga Komuna:

1. Arta Gashi
2. Agim Bylykbashi
3. Shpresim Kuçi

Pjesëmarrës nga fshati: 10

M: 7

F: 3

- Kryetari i fshatit hap takimin dhe përshëndet pjesëmarrësit.
- Nënkyetarja Arta Gashi përshëndet pjesëmarrësit dhe spjegon se çka janë dëgjimet publike.
- Agim Bylykbashi prezanton buxhetin për 2026 dhe 2027 si dhe tregon për problemet buxhetore në fillim të vitit dhe për projektet e parapara për fshat.
- **Sefer Bajraktari:** Kërkon buxhet më të lartë për fshat dhe ankohet se buxheti është më i vogël se vitet e kaluara. Kërkon që kur të ndahet buxheti të llogariten edhe mërgimtarët.
- Tregon se ka rreth 30 rrugë të pa rregulluara në fshat.
- Kërkon të rregullohet kanalizimi te rr. "Avni Hodaj" si dhe të mirëmbahet trotuari sepse rrezikohen fëmijët.
- Pyet se çka ndodh me shkollën e vjetër dhe propozon që të rikonstruktohet në shtëpi për të moshuar ose si shtëpi e kulturës.
- **Salih Morina:** Propozon të sillet uji ose të hapet pusi te shkolla e re e fshatit, transport publik për nxënës si dhe të pastrohet trotuari nga barishtet te rruga e shkollës.
- Agim Bylykbashi tregon se jemi në bisedime me Komunat e Rahovecit dhe Mamushës që të sillet gypi i ujësjesit nga këto Komuna.
- **Ganimete Morina:** Ankohet se pranë shkollës së re gjinden 3 gurëthyes dhe nxënësit mund të rrezikohen.
- Kërkon që shkolla e vjetër të bëhet rekreacion sportiv për rini.
- Kërkon pengesa në rrugë (polic të vdekur) te shkolla e re sepse rrezikohen fëmijët.
- Arta Gashi spjegon se lejet mjedisore i jep ministria dhe nuk pyet komunën për lokacione.
- Premton që nxënësit do të kenë transport si dhe do sigurohet uji te shkolla.
- Mirëpret idenë që shkolla e vjetër të kthehet në shtëpi për pleq.
- Tregon se për rrugët magjistrale është kompetencë e ministrisë që të vendos pengesat në rrugë.
- **Lulzim Ahmeti:** Kërkon rregullimin e ndriqimit publik.
- Arta Gashi tregon që po punohet në shumë fshatra dhe shpejtë do të rregullohet në çdo lagje.
- **Qazim Voci:** Kërkon të mirëmbahet trotuari te shkolla, vend rekreacioni te parku i

- Agim Bylykbashi tregon për shetitoret që janë realizuar si dhe kërkon nga fshati të organizohen edhe vetë për pastrimin e fshatit.

- **Sefer Bajraktari:** Ankohet për ndriqim publik dhe për punë të dobët nga punëkryesi te parku i dëshmorëve si dhe kërkon pllakë përkujtimore për martirët e luftës.

- Arta Gashi propozon të krijohet një OJQ e fshatit për mirëmbajtje të parqeve, trotuareve dhe tregon se mund të bëhet pllaka.

Procesmbajtës: Shpresim Kuqi



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
OPSTINE SUVA REKA
THE MUNICIPALITY OF SUHAREK



Lista e pjesëmarrësve në dëgjime publike në

SAMADREXHË

Data: 20/05/2026

Nr	Emri dhe mbiemri	Vendi	Nënshkrimi
1	Ganimete Merina	Samadrexhë	
2	Yusufim Ahmeti	SAMADREXHË	
3	XHEVAT KOTORLI	SAMADREXHË	
4	Riona Bylykbashi	SAMADREXHË	
5	Meti BYLYGBASHI	SAMADREXHË	
6	Njoma Bylykbashi	SAMADREXHË	
7	Faton Morina	SAMADREXHË	
8	Sali Musaj	SAMADREXHË	
9	Qazim Leci	SAMADREXHË	
10	Sefer Bajraktari	— " —	
11			
12			
13			